

TITULLI I PROJEKTIT:

Matematika në lëvizje
Klasa e parë

Fusha e matematikës

PËRSHKRIM I PROJEKTIT: Në kuadër të projektit „Matematika në lëvizje”, nxënësit organizohen të marrin pjesë, një aktivitet që synon të sjellë konceptet matematikore në përditshmërinë e fëmijëve përmes lojës, bashkëpunimit dhe lëvizjes.


Ky projekt zhvillohet jashtë klasës tradicionale dhe përfshin lojëra interaktive në natyrë, gara matematikore, zgjidhje problemesh në grupe dhe aktivitete me mjete konkrete.

Qëllimi është që nxënësit të përforcojnë njohuritë matematikore në mënyrë argëtuese dhe kreative, duke nxitur mendimin logjik, komunikimin dhe punën ekipore.

„Matematika në lëvizje” synon gjithashtu të forcojë vetëbesimin e nxënësve në këtë lëndë duke u ofruar përvoja positive dhe të paharrueshme për rrugëtimin e tyre.



LËNDËT QË DO TË NDËLIDHEN NË PROJEKT



IDEJA E PROJEKTIT



Nxënësit në shkollë kalojnë një pjesë të madhe të kohës duke mësuar edhe nëpërmjet lojës, argëtohen shoqërohen dhe jovetëm.



Ndihen të lumtur dhe kënaqen kur realizojnë veprimtari dhe projekte të ndryshme.



Përmes këtij projekti, fëmijët përforcojnë njohuritë matematikore.



Nxitet mendimi logjik, komunikimi dhe bashkëpunimi midis fëmijëve.



Ata njihen për së afërmi me problemet matematikore duke e ndërlidhur me jetën reale.



Nxënësit shfrytëzojnë njohuritë e marra gjatë kësaj periudhe për punën që do ta finalizojnë.

KOMPETENCAT KRYESORE PËR SHKALLË

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv


Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ



Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm


Kompetenca për jetë, punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm







Produkti
final

Poster kolektiv me numra
dhe figura apo ilustrime të
ndryshme me mbledhje
dhe zbritje

Album me fletë pune të
punuara nga nxënësit

Ekspozitë me
punime të lira
dhe lojë me
kartela



Vlerësimi

Vëzhgim i përfshirjes së
fëmijëve

Prezantim punës nga
vet nxënësit

Reflektim me gojë:
"Çfarë më pëlqeu?
Çfarë mësova?"

Në vazhdim vendosen foto gjatë punës dhe prezantimit të projektit.